



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 24 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Afatit për t'iu Përgjigjur
Kërkesave për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00450**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 9 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), nxjerr këtë urdhër.

I. HSITORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 31 gusht 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendim mbi Mocionet që Ngrënë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve (“Vendimi i 31 Gushtit 2021”).²
2. Më 2 shtator 2021, Mbrojtja e Hashim Thaçit (“Mbrojtja e Thaçit”) dorëzoi një kërkesë për zgjatjen e afatit deri më 17 shtator 2021 për parashtrimin e kërkesës për leje për apelimin e Vendimit të 31 Gushtit 2021 (“Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit”).³
3. Më 6 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për zgjatjen e afatit dhe urdhëroi, *proprio motu*, edhe ekipet e tjera të Mbrojtjes që deri më 17 shtator 2021 të parashtronin kërkesat e tyre për leje për apelimin e Vendimit të 31 Gushtit 2021.⁴

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00450, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet që Ngrënë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve*, 31 gusht 2021 (njoftuar më 1 shtator 2021), publik.

³ KSC-BC-2020-06, F00452, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Zgjatjen e Afatit për Parashtrimin e Kërkesës për Leje për Apelim të “Vendimit mbi Mocionet që Ngrënë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve”*, 2 shtator 2021 (njoftuar më 3 shtator 2021), publike, para. 3, 8.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00458, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Përmbledhës mbi Kërkesat për Zgjatje të Afatit*, 6 shtator 2021, publik, para. 11.

4. Më 17 shtator 2021, Mbrojtja e Thaçit dhe Mbrojtja e Kadri Veselit (bashkërisht "Mbrojtja") dorëzuan mocionet ku kërkonin leje për apelimin e Vendimit të 31 Gushtit 2021 ("Mocionet e Mbrojtjes").⁵

5. Më 24 shtator 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") parashtrroi kërkesë për zgjatjen e afatit deri më 6 tetor 2021 për t'iu përgjigjur Mocioneve të Mbrojtjes ("Kërkesa").⁶ ZPS-ja argumenton se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit si rezultat i: (i) natyrës së ndërlikuar dhe të re të aspekteve që gjykohen në Vendimin e 31 Gushtit 2021; (ii) numrit të çështjeve për të cilat është kërkuar leje për apel në Mocionet e Mbrojtjes; (iii) afatet e njëkohshme të kontestimeve juridike të ndërlikuara me të cilat përballet ZPS-ja; dhe (iv) faktit se Mbrojtjes i është miratuar zgjatje afati për përgatitjen e Mocioneve të Mbrojtjes.⁷

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, Paneli mund të zgjasë ose të shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje ose prej Panelit.

7. Në pajtim me rregullën 9(6) të Rregullores, në qoftë se nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtare, vendimi mbi një kërkesë për ndryshimin e afatit mund të merret pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00473, Mbrojtja e Hashim Thaçit, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të "Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve"*, 17 shtator 2021, publike; F00474, Mbrojtja e Kadri Veselit, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime për Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljes së Kushtetutës (KSC-BC-2020-06/F00450)*, 17 shtator 2021, publike.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00488, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Kërkesë për Zgjatjen e Afatit për t'iu Përgjigjur Kërkesave për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-06/F00450*, 24 shtator 2021, publike.

⁷ Kërkesa, para. 2.

III. DISKUTIM

8. Në lidhje me kërkesën për zgjatjen e afatit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se natyra e ndërlikuar dhe e re e aspekteve të gjykuara në Vendimin e 31 Gushtit 2021 dhe numri i çështjeve për të cilat kërkohet leje për apelim, përlligjin zgjatjen e afatit të ZPS-së për t'u përgjigjur. Gjykatësi i Procedurës gjithashtu mban parasysh se Mbrojtjes iu miratua zgjatje e afatit për përgatitjen e Mocioneve të Mbrojtjes. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme që përlligjin zgjatjen e kërkuar të afatit.

9. Për të njëjtat arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *proprio motu*, miraton zgjatjen e afatit të Mbrojtjes për t'iu kundërpërgjigjur përgjigjes së ZPS-së.

10. Së fundi, meqë Mbrojtjes i miratohet kohë shtesë për t'iu kundërpërgjigjur përgjigjes së ZPS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se nuk do t'i shkaktohet padrejtësi Mbrojtjes përmes zgjatjes së afatit të ZPS-së.

IV. VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **ZGJAT** afatin e ZPS-së për dorëzimin e përgjigjes ndaj Mocioneve të Mbrojtjes deri të mërkurën, **6 tetor 2021**; dhe
- c) **ZGJAT**, *proprio motu*, afatin për çdo kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së ZPS-së, deri të **hënën, 18 tetor 2021**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premte, 24 shtator 2021
Në Hagë, Holandë